



Fjalorth

i dhunës me bazë

gjimore të kryer

nëpërmjet teknologjisë

bodyright

03

Pse ky fjalorth dhe si ta përdorim atë?

09

Shpifja në hapësirën online ndaj personave që kanë përjetuar dhunë

Dhuna seksuale në mjedisin digjital

Abuzimi me anë të përmbajtjes vizuale

05

Përkufizimet ombrellë të dhunës me bazë gjinore të ushtruar përmes teknologjisë

10

Fotografi të bëra nën-fustan pa pajtimin e femrave dhe fotografime perverse

Pornografia pa pëlqim dhe zhvatja në baza seksuale

06

Format e dhunës me bazë gjinore të kryera/lehtësuara përmes teknologjisë

I Kiber-dhuna (apo dhuna digjitale) dhe ngacmimi online me bazë gjinore

Ngacmimi i rrjetëzuar dhe ngacmimi në platforma të ndryshme

11

Media seksuale sintetike, falsifikimi i theksuar (deepfake) dhe pornografi e falsifikuar apo e rreme (deepfake)

Seksting (dërgim i mesazheve me tekste apo materiale pornografike) dhe seksting abuziv

07

Gjuha e urrejtjes gjinore dhe seksiste

Turpërimi seksual online

12

Kiber-ekzibicionizëm, pornografi e padëshiruar dhe foto dikpik/të padëshiruara të penisit

Regjistrimi dhe/ose transmetimi i sulmeve seksuale dhe përdhunimeve

Parapërgatitje (grooming) në internet

08

Tallja (trolling), dhe tallja me bazë gjinore, nxitja dhe tallja (trolling) me qëllim të frikësimit

Hakmarrja ndaj mbështetësve të të mbijetuarve të dhunës

13

Përvoja të padëshiruara seksuale të drejtpërdrejta, të mundësuara nga teknologjia

Trafikimi dhe rekrutimi i qenieve njerëzore i ndihmuar nga teknologjia

14

Kërcënimi i privatësisë dhe sigurisë
përmes teknologjisë

Doks-imi, dednejm-imi dhe autimi pa pëlqim

18

Forma të tjera të dhunës
në mjedisin digjital

Astroturf-imi

Akuzat e rreme për blasfemi

15

Prezantimi i rrejshëm dhe ketfish-imi

Kufizimi apo kontrollimi nëpërmjet
teknologjisë

19

Tallje (angl. trolling) dhe tallje pas
vdekjes bazuar në tronditje dhe pikëllim

Svot-imi (angl. swatting)

Helmimi i hashtag-ut
(angl. hashtag poisoning)

16

Abuzimi elektronik financiar

Ndjekje kibernetike dhe përcjellje
obsesive në internet

Sulme "në jetën reale"

21

Koncepte (terma) nga fusha
e teknologjisë

17

Kërcënimi online

Bombardimi në Google dhe Zoom

Sulmi përmes mohimit të qasjes,
dhe sulmi përmes mohimit të shërbimeve



// Trupi yt është i yti
si në internet ashtu edhe në
botën reale

// Pse ky fjalorth dhe si ta përdorim atë?

Dhuna me bazë gjinore, e kryer/lehtësuar përmes teknologjisë (në gjuhën angleze technology-facilitated gender-based violence, shkurtesa TFGBV) është një fenomen relativisht i fundit, i cili ishte pothuajse i paimagjinueshëm tridhjetë vjet më parë. Teksa teknologjitë e informacionit dhe komunikimit u bënë gjithnjë e më të përhapura në jetën tonë të përditshme, në masë që tashmë është vështirë të imagjinohet dita më e zakonshme pa internet, laptop, telefon të mençur apo rrjete sociale, kështu edhe dhuna me bazë gjinore që ushtrohet në hapësirën digjitale u bë gjithnjë e më e shpeshtë.

Të dhënat tregojnë se një numër i madh i grave në mbarë botën kanë përjetuar një formë të dhunës me bazë gjinore të kryer përmes teknologjisë dhe se vajzat, adoleshentet dhe gratë e reja janë veçanërisht të cenueshme - 58% e tyre kanë përjetuar një formë të dhunës me bazë gjinore në mjedisin digjital, ku në shumicën e rasteve kjo ka ndodhur ndërmjet moshës së katërmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë vjeç të tyre, dhe pothuajse gjysma e tyre (47%) kanë hasur në kërcënime të dhunës fizike dhe seksuale. Hulumtimet gjithashtu tregojnë se 45% e grave që kanë përjetuar dhunë në marrëdhëniet intime me partnerët, janë abuzuar edhe nëpërmjet teknologjisë, dhe për 48% të tyre dhuna me bazë gjinore nëpërmjet teknologjisë ka vazhduar edhe pas përfundimit të marrëdhënies.ⁱⁱ

Shkaku i të gjitha të sipër-përmendurave, në prill 2022, Bashkimi Evropian filloi punën për krijimin e një kuadri ligjor për rregullimin e dhunës me bazë gjinore, në mënyrë që ai të përfshijë edhe dhunën që kryhet përmes teknologjisë.ⁱⁱⁱ

Megjithatë, edhe pse dhuna me bazë gjinore e ushtruar përmes teknologjisë po bëhet gjithnjë e më e shpeshtë, duke u njohur si kërcënim edhe në aktet juridike ndërkombëtare, ende nuk ka një marrëveshje të përbashkët për përcaktimin e saj, si dhe përcaktimin e formave të saja të manifestuara. Kjo është arsyeja pse termat “ngacmim” dhe “abuzim”, si dhe termat “kiber (cyber)”, “digjital”, “online” dhe “përmes teknologjisë”, përdoren shpesh si sinonime kur flitet për këtë formë dhune. Gjithashtu, numri i formave të kësaj lloji dhune nuk është ende përfundimtar - me avancimin e teknologjisë, shfaqen dhe mundësi të reja për abuzimin e saj me qëllim të kryerjes së dhunës me bazë gjinore.

Në fjalorthin para jush janë paraqitur dy përkufizime ombrellë të dhunës me bazë gjinore të ushtruar përmes teknologjisë, të cilat në praktikë janë dëshmuar të jenë më të rëndësishmet dhe më gjithëpërfshirëset, ndërkohë që format e ndryshme të kësaj lloji dhune janë veçuar bazuar në përfaqësimin apo përdorimin e tyre në Ballkanin Perëndimor. Format e shfaqura të dhunës janë ndarë në katër grupe të mëdha, me qëllim që lexuesit dhe lexueset ta kenë më të lehtë të kuptuarit e kësaj terminologjie. Kjo ndarje nuk është as përfundimtare dhe as e

pandryshueshme, pasi forma të ndryshme të dhunës përmes teknologjisë shpesh ndërthuren dhe i paraprijnë njëra-tjetrës. Çdo formë është përshkruar, përkufizuar dhe ilustruar me një shembull nga jeta reale, me qëllim të njohjes së formës së dhunës, por edhe për të vënë në dukje rrezikun që paraqet dhuna me bazë gjinore nëpërmjet teknologjisë për jetën e vajzave, adoleshenteve dhe grave, si dhe personave me variante gjinore.

Grupi i parë përbëhet nga dhuna kibernetike (ose digjitale) dhe ngacmimet në internet me bazë gjinore, që përfshin forma dhe lloje të ndryshme të ngacmimeve dhe abuzimeve në hapësirën digjitale, më së shpeshti të kryera përmes tekstit. Këto janë ngacmimet në internet dhe ngacmime në platforma të ndryshme, gjuha e urrejtjes gjinore dhe seksiste (përfshirë dhe turpërimin seksual në internet, tallje (trolling), tallje (trolling) me bazë gjinore, nxitje dhe tallje (trolling) me qëllim të frikësimit), hakmarrje për mbështetjen e viktimave të dhunës dhe shpifje në internet.

Grupi i dytë përfshin dhunën seksuale në mjedisin digjital, me theks të veçantë në përvojat e padëshiruara seksuale të ndërmjetësuar nga teknologjia. Ky grup është i ndarë nga ai paraprak për shkak të komponentit gjinor jashtëzakonisht të theksuar dhe përhapjes në rritje. Në kuadër të tij dallohen: abuzimi përmes përmbajtjeve vizuale (që përfshin fotografi të bëra nën-fustan pa pajtimin e femrave (upskirting) dhe fotografime perverse; pornografi pa pëlqim dhe zhvatje në baza seksuale; media seksuale sintetike, falsifikim i theksuar (deepfake) dhe pornografi e falsifikuar apo e rreme (deepfake); seksting (dërgim i mesazheve me tekste apo materiale pornografike) dhe seksting abuziv; kiber-ekzibicionizëm, pornografi e padëshiruar dhe foto të padëshiruara të penisit (dickpic), regjistrimi dhe/ose transmetimi i sulmeve dhe përdhunimeve seksuale, parapërgatitje (grooming) në internet, përvoja të padëshiruara seksuale të drejtpërdrejta, të mundësuar nga teknologjia, dhe trafikimi dhe rekrutimi i qenieve njerëzore e ndihmuar nga teknologjia.

Grupi i tretë përbëhet nga format e dhunës që synojnë të kërcënojnë sigurinë dhe privatësinë përmes teknologjisë. Ai përbehet nga doksimi, dednejm-imi (nxjerrja në shesh i emrave/pseudonimeve të përdorura nga personat me variante gjinore) dhe autimi (nxjerrja në shesh i orientimit seksual të personave me variante gjinore) pa pëlqim të këtyre personave; prezantimi i rrejshëm dhe ketfish-imi (prezantim i rrejshëm me qëllim të mashtrimit); kufizimi apo kontrollimi nëpërmjet teknologjisë; abuzimi elektronik financiar; ndjekje kibernetike dhe përcjellje obsesive në internet; sulme "në jetën reale"; kërcënime online; bombardime në Google dhe Zoom; si dhe sulmi përmes mohimit të qasjes, dhe sulmi përmes mohimit të shërbimeve.

Grupi i katërt përfshin forma të tjera të dhunës në mjedisin digjital - ato që nuk përfshihen në njësitë e mëparshme, dhe që mund të kenë një dimension gjinor, megjithëse nuk kuptohen në të njëjtën mënyrë siç kuptohen në tre grupet e mëparshme. Një tjetër karakteristikë e përbashkët e këtyre formave të dhunës është fakti se frekuenca e tyre në Ballkanin Perëndimor është më e ulët në krahasim me grupet e mëparshme, gjë që nuk do të thotë se kjo nuk do të ndryshon në të ardhmen. Këtu përfshihen astroturfing, akuza të rreme për blasfemi, tallje (trolling) pas vdekjes, dhe tallje (trolling) në bazë të tronditjeve dhe pikëllimit, svot-imi (swatting), dhe helmimi i heshtag-ut (hashtag poisoning).

Në fund të fjalorthit gjendet edhe një fjalor i shkurtër i koncepteve (termave) nga fusha e teknologjisë, në të cilin shpjegohen katërmbëdhjetë koncepte nga fusha e teknologjisë me qëllim të lehtësimit të kuptimit të formave të lartpërmendura të dhunës.

// Përkufizimet ombrellë të dhunës me bazë gjinore të ushtruar përmes teknologjisë

<p>Kombet e Bashkuara ^{iv}</p>	<p>Dhuna online ndaj grave dhe vajzave e ndërmjetësuar nga teknologjia e informacionit dhe komunikimit</p>	<p>Përkufizimi i dhunës online ndaj grave i referohet çdo akti të dhunës së bazuar në gjini (DHBGJ) ndaj grave që kryhet, lehtësohet ose pasojat e së cilës përkeqësohen me përdorimin e pjesëshëm ose të plotë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (si telefonat celularë dhe telefonat e mençur, interneti, platformat e rrjeteve sociale ose postës elektronike), dhe e cila drejtohet kundër një gruaje thjesht sepse ajo është grua ose prek gratë në mënyrë disproporcionale.</p>
<p>Instituti Evropian për barazi gjinore ^v</p>	<p>Dhuna kibernetike ndaj grave dhe vajzave</p>	<p>DHBGJ e kryer përmes komunikimit elektronik dhe internetit. Edhe pse dhuna kibernetike mund të prekë si burrat ashtu edhe gratë, gratë dhe vajzat përjetojnë forma të më ndryshme dhe më traumatike të dhunës kibernetike.</p> <p>Ekzistojnë forma të ndryshme të dhunës kibernetike ndaj grave dhe vajzave, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, ndjekjen kibernetike, pornografinë pa pëlqim (apo "pornografi hakmarrëse", angl. revenge porn); sharjet me bazë gjinore (angl. slurs)¹; gjuhën e urrejtjes dhe ngacmimet; "turpërimin përmes seksit" (angl. slut-shaming); pornografi të padëshiruar; zhvatje me bazë seksi (angl. sextortion); kërcënime me përdhunim dhe vdekje; si dhe trafikim njerëzor të asistuar në mënyrë elektronike. Ngacmimi kibernetik nuk është një fenomen i ndarë/veçantë nga dhuna "reale", pasi shpesh ndjek të njëjtat modele si ngacmimi real (offline).</p>

¹ Fyerjet me bazë gjinore nënkuptojnë gjuhën e urrejtjes me bazë gjinore dhe seksiste .

Format e dhunës me bazë gjinore të kryera/lehtësuara përmes teknologjisë

I Kiber-dhuna (apo dhuna digjitale) dhe ngacmimi online me bazë gjinore

Kiber-dhuna (apo dhuna digjitale) (angl. cyberbullying) është një koncept (term) ombrellë që përfshin forma të ndryshme të dhunës në internet, pra dhuna që kryhet nëpërmjet teknologjisë. Përkufizohet si "shkaktimi dhe përsëritja e dëmtimit me vetëdije me ndihmën e kompjuterëve, celularëve ose pajisjeve të tjerë elektronike"^{vi}, më së shpeshti përmes përdorimit të përmbajtjeve tekstuale ose grafike, me qëllim që një person të frikësohet, të ndikohet negativisht në vetëbesimin e tij/saj, apo të i dëmtohet reputacioni i tij/saj.^{vii} Megjithëse ky term më së shpeshti i referohet dhunës së bashkëmoharëve në internet, në të cilën individë ose një grup bashkëmoharësh bashkohen për të nënçmuar një person tjetër dhe për të shkaktuar dëme në reputacionin, personalitetin dhe dinjitetin e tij/saj, objektivi i dhunës kibernetike mund të jenë edhe të rriturit.^{viii} ^{ix} Autorët/keqbërësit mund të jenë persona të njohur, por edhe persona të panjohur.

Kur dhuna kibernetike, më së shpeshti e kryer në forma teksti, i drejtohet një personi për shkak të seksit, gjinisë, seksualitetit ose orientimit seksual, ne përdorim termin ngacmimi online me bazë gjinore (angl. online [gender] harassment). Ngacmimi në internet me bazë gjinore mund të ketë forma të ndryshme - një person mund të kontaktohet vazhdimisht dhe pa pëlqimin e tij, ai mund të kërcënohet, mund të frikësohet duke i dërguar fotografi ose komente të padëshiruara, të pakëndshme, poshtëruese ose fyese (gjuhë urrejtjeje gjinore dhe seksiste), ose të përhapet shpifje ndaj tij. Autorët e ngacmimeve në internet me bazë gjinore janë më së

gjinore janë më së shpeshti meshkuj (individë) ose grupe meshkujsh (ngacmimi i rrjetëzuar), dhe ngacmimet mund të kryhen si në platforma të shumta në të njëjtën kohë, ashtu edhe në një platformë.^x

Me ngacmimin në internet me bazë gjinore nënkuptojmë ngacmimin e rrjetëzuar dhe ngacmimin në platforma të ndryshme, gjuhën e urrejtjes gjinore dhe seksiste, ku bëjnë pjesë turpërimi seksual në internet, tallja (trolling), dhe tallja me bazë gjinore, duke përfshirë nxitjen dhe talljen (trolling) me qëllim të frikësimit, dhe hakmarrjen ndaj mbështetësve të mbijetuarve të dhunës dhe shpifjes në hapësirën online.

b) Ngacmimi i rrjetëzuar dhe ngacmimi në platforma të ndryshme

Ngacmimi i rrjetëzuar, shpeshherë i referuar edhe si kiber-mobing (kiber-sulm grupor, angl. cyber mobbing), përbehet nga sulme të organizuara, të koordinuara dhe sistematike nga një grup njerëzish ndaj individëve (burra apo gra) të caktuar/a, ose ideve, siç bëjnë grupet që sulmojnë feministët, ose që sulmojnë ata që luftojnë kundër racizmit.^{xi} Ngacmimi në grup udhëhiqet nga psikologjia e turmës, e cila fokusohet në ekspozimin publik, poshtërimin dhe ndëshkimin e personit që është objektivi i sulmit. Në shumicën e rasteve, një person vihet në shënjestër thjesht sepse ndan një opinion mbi tema politike ose ide me të cilat grupi i sulmuesve nuk pajtohet.^{xii} Ngacmimi i rrjetëzuar mund të bëhet në një platformë, por mund të kryhet edhe në disa platforma në të njëjtën kohë - atëherë bëhet fjalë për ngacmim në platforma të ndryshme (angl. cross-platform harassment), gjatë së cilës ngacmuesit përfitojnë nga fakti që shumica e platformave moderojnë vetëm përmbajtjen e faqes së tyre.^{xiii}

Objektiv i shpeshtë i ngacmimeve të rrjetëzuara në një ose më shumë platforma janë gazetaret femra. Një sondazh i kryer nga UNESCO zbuloi se 40% e gazetareve femra ishin shënjestër e ngacmimeve në internet me bazë gjinore që ishin të rrjetëzuara. Në këtë mënyrë u bënë fushata kundër tyre. Një në dhjetë gazetarë, pas ngacmimeve në internet me bazë gjinore, mun

guan nga vijimi i rregullt i punës; një në tre gazeta-
tare u detyrua të ishte më pak e dukshme në
publik (ato përdorën pseudonime ose emisionet
e tyre u hoqën nga programi), 4% dhanë
dorëheqje nga puna, dhe 2% plotësisht hoqën
dorë nga karriera e tyre si gazetares.^{xiv}

b) Gjuha e urrejtjes gjinore dhe seksiste

Gjuha e urrejtjes gjinore dhe seksiste (angl. [Gen-
dered or sexist] hate speech) përfshin çdo lloj
komunikimi, nëpërmjet të folurit, tekstit ose
sjelljes jo-verbale, që sulmon, poshtëron, fyen
dhe diskriminon një person në bazë të seksit,
gjinisë, orientimit seksual ose identitetit gjinor.
Gjuha e urrejtjes gjinore dhe seksiste në internet
mbështet seksizmin sistematik², ndërkohë që
dehumanizon gratë, vajzat dhe personat
LGBTQIA+, dhe nxit dhunën kundër tyre. Gjuha e
urrejtjes gjinore dhe seksiste përfshin turpërimin
dhe talljen (trolling) mbi seksin, veçanërisht
talljen (trolling) me bazë gjinore, duke përfshirë
dhe nxitjen dhe talljen (trolling) me qëllim të
frikësimit.

b) Turpërimi seksual online

Turpërimi seksual online (angl. slut-shaming
online), që shpeshherë quhet dhe slatshejmimi,
është një formë e dhunës me bazë gjinore e
drejtuar shpesh ndaj vajzave adoleshente dhe
personave LGBTQIA+, të cilët diskriminohen dhe
poshtërohen sepse nuk plotësojnë normat
sociale dhe gjinore në lidhje me sjelljen
seksuale, pamjen dhe seksualitetin. Turpërimi
seksual në internet shpesh përputhet me përnd-
jekjen kibernetike, shpërndarjen e pornografisë
pa pëlqim, dhe ngacmimet e rrjetëzuara, përmes
së cilave fuqizohet ndikimi negativ mbi personat
që janë cak i sjelljeve të tilla.^{xvi}
Turpërimi seksual në internet më së shpeshti
manifestohet përmes ofendimeve, qofshin
komente apo foto, meme, video-regjistrime dhe
animacione, me qëllim poshtërimin e një personi
në bazë të gjinisë, seksualitetit dhe sjelljes
seksuale. Përveç njerëzve që perceptohen si
devijues ose të shthurur për shkak se sjellja,
pamja ose veshja e tyre nuk përputhet

me normat patriarkale, caqet e turpërimin seksu-
al në mjedisin digjital janë edhe personat që i
kanë mbijetuar dhunës seksuale, e që bazohet
në besimin e pasaktë se sjellja e tyre shkaktoi
ngacmim nga dhunuesi.^{xvii}

b) Tallja (trolling), dhe tallja me bazë gjinore, nxitja dhe tallja (trolling) me qëllim të frikësimit

Gjuha e urrejtjes gjinore dhe seksiste (angl. [Gen-
dered or sexist] hate speech) përfshin çdo lloj
komunikimi, nëpërmjet të folurit, tekstit ose
sjelljes jo-verbale, që sulmon, poshtëron, fyen
dhe diskriminon një person në bazë të seksit,
gjinisë, orientimit seksual ose identitetit gjinor.
Gjuha e urrejtjes gjinore dhe seksiste në internet
mbështet seksizmin sistematik, ndërkohë që
dehumanizon gratë, vajzat dhe personat
LGBTQIA+, dhe nxit dhunën kundër tyre. Gjuha e
urrejtjes gjinore dhe seksiste përfshin turpërimin
dhe talljen (trolling) mbi seksin, veçanërisht
talljen (trolling) me bazë gjinore, duke përfshirë
dhe nxitjen dhe talljen (trolling) me qëllim të
frikësimit.

b) Turpërimi seksual online

Tallja (angl. trolling) është formë e dhunës kiber-
netike, qëllimi i së cilës është të bezdisë njerëzit
e tjerë dhe/ose ta bëjë të pakuptimtë diskutimin
në internet për një temë të caktuar dhe të paran-
dalojë një shkëmbim konstruktiv dhe të civilizuar
të mendimeve të ndryshme. Tallja më së shpe-
shti bëhet me tekst, duke postuar komente posh-
tëruese ose fyese. Trollët (tallësit, angl. trolls) e
shijojnë këtë, dhe kur atyre u vihen në dukje
pasoja e rrezikshme të sjelljes së tyre, mohojnë
përgjegjësinë e tyre, duke pretenduar se e gjitha
është një shaka dhe se të tjerët "nuk kanë sens
humori". Tallja në bazë të gjinisë (angl. gender
trolling) i ka vajzat, adoleshentet dhe gratë si
objektiva të abuzimit, dhe kjo vetëm sepse ato
janë femra. Tallja me bazë gjinore përfshin
përdorimin e fyerjeve me bazë gjinore, gjuhën
seksiste dhe mizogjene në mesazhe dhe
komente, krijimin e thurjeve (angl. hashtags) të
dhunshëm dhe fyes që bëjnë thirrje për dhunë
ndaj grave, por edhe kërcënime me

² Seksizmi paraqet besimin se burrat janë superiorë ndaj grave, dhe në bazë të këtij besimi, diskriminimi në bazë të gjinisë ose seksit konsiderohet i justifikuar. Kur ky besim dhe diskriminim bëhen të përhapur (për shembull, në institucione ose në media), ne flasim për seksizëm sistematik.

vdekje ose përdhunim.^{xviii} Forma më e dhunshme e talljes me bazë gjinore është nxitja (angl. flaming), që konsiston në postimin ose dërgimin e mesazheve fyese nëpërmjet internetit me qëllim të shqetësimit dhe frikësimit të një personi. Mesazhe të tilla postohen në forume dhe/ose grupe të tjera të shkëmbimit të informatave në internet, ose dërgohen me postë elektronike dhe/ose mjete të tjera të mesazheve në internet. Një formë e veçantë e talljes është tallja me qëllim frikësimi, kur qëllimi është të frikësohet një person duke thënë se do të sulmohet jashtë kontekstit digjital, sepse tallësit e sigurojnë personin që dhunuesi di se si ta gjejë atë.^{xix} Shumë tallës janë anonimë dhe përdorin llogari të rreme interneti, dhe ndodh që ata edhe të bashkohen për të kryer ngacmime të rrjetëzuara. Pavarësisht nga forma e talljes, ajo shpesh ndjek ose i paraprin formave të tjera të dhunës në mjedisin digjital.

Përveç formës tekstuale, tallja në bazë të gjinisë mund të jete dhe vizuale, kur dërgohen apo postohen foto, meme, animacione dhe video-regjistrime, qëllimi i të cilëve është të bezdisin dhe provokojë vajzat, adoleshentet dhe gratë, si dhe të nxisin dhunën ndaj tyre.^{xx}

b) Hakmarrja ndaj mbështetësve të mbijetuarve të dhunës

Kjo formë e dhunës përfshin kërcënimet dhe ngacmimet e anëtarëve të familjes, miqve, punëdhënësve ose komunitetit që ofron mbështetje për të mbijetuarin e dhunës.^{xxi} Megjithëse hakmarrja ndaj mbështetësve të mbijetuarve të dhunës (angl. retaliations against supporters of survivors) ka origjinën nga bota reale (offline), në epokën e lëvizjes #MeToo, kur gjithnjë e më shumë gra ndihen të fuqizuara për të folur në internet për dhunën që kanë përjetuar, dhe gjithnjë e më shumë persona për t'u ofruar atyre mbështetje, forma digjitale e hakmarrjes për mbështetjen e personave që i kanë mbijetuar dhunës po bëhet gjithnjë e më i përhapur. Në botën digjitale, përveç njerëzve nga mjedisi më i gjerë dhe më i afërt i viktimave të dhunës, në shënjestër janë edhe

persona të panjohur për ta, e që i kanë ofruar mbështetjen tyre.

Kryetarja e Komisionit për Gratë në Delhi, Swati Maliwal, mori kërcënime për përdhunim në llogarinë e saj në Instagram, pasi ajo i shkroi ministrit Anurag Thakur duke kërkuar largimin e regjisorit Sajid Khan nga emisioni televiziv Bigg Boss. Maliwal ia dërgoi kërkesën e saj ministrit si një akt mbështetjeje për aktoret që e akuzuan Sajid Khan-in për dhunë seksuale dhe ngacmime, për të cilat ato folën publikisht duke e përdorur thurjen #MeToo.^{xxii}

b) Shpifja në hapësirën online

Shpifja në hapësirën online (angl. online defamation ose online libel) i referohet publikimit dhe shpërndarjes së informatave të ndryshuara apo të rremë që dëmton reputacionin e një personi nëpërmjet internetit. Qëllimi i shpifjes është të poshtërojë, kërcënojë, diskreditojë, frikësojë ose ndëshkojë një person, dhe më së shpeshti u drejtohet figurave publike: për shembull, zyrtarëve publikë, aktivistëve dhe gazetarëve (meshkuj dhe femra).^{xxiii}

Gjatë vitit 2021, qeveria Australiane paralajmëroi futjen e shpifjes në hapësirën online si akt penal. Ky projektligj do t'i detyrojë rrjetet sociale, si Twitter dhe Facebook, ta zbulojnë identitetin e llogarive anonime që kryejnë shpifje, duke i lejuar viktimat të kërkojnë drejtësi në gjykatë nëse postime të tilla nuk hiqen nga interneti.^{xxiv}

Dhuna seksuale në mjedisin digjital

Dhuna seksuale në mjedisin digjital përfshin forma të ndryshme të abuzimit seksual që kryhet nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe komunikimit dhe/ose kryhet në mjedisin digjital. Ajo përfshin abuzim me anë të përmbajtjes vizuale, pavarësisht nëse materiali vizual është real apo është marrë përmes manipulimit të programeve kompjuterike - në rastin e dytë, bëhet fjalë për dipfejk (falsifikim i theksuar, angl. deepfake). Ngacmimi me anë të përmbajtjes

vizuale (dickpic). Dhuna seksuale në mjedisin digjital, për fat të keq, shpesh kalon dhe bashkë-ndodh me dhunën seksuale në botën reale (offline), dhe kur kjo ndodh, flasim për parapërgatitje (grooming) në internet; përvoja të padëshiruara seksuale të drejtpërdrejta, të mundësuar nga teknologjia; dhe trafikimi i qenieve njerëzore e ndihmuar nga teknologjia. Dhuna seksuale në mjedisin digjital mund gjithashtu të përfaqësojë vazhdimin e dhunës seksuale në botën reale (offline) - shembull është praktika e video-regjistrimeve dhe/ose transmetimeve të sulmeve seksuale dhe përdhunimeve.

b) Abuzimi me anë të përmbajtjes vizuale

Abuzimi me anë të përmbajtjes vizuale (angl. image-based abuse, IBA) është një term ombrellë që përfshin forma të ndryshme të dhunës seksuale me bazë gjinore në hapësirën digjitale.^{xxv} Abuzimi përmes përmbajtjes vizuale bazohet në bërjen, dërgimin ose kërcënimin me dërgim të fotove ose videove të natyrës intime ose seksuale me qëllim të ngacmimit, shantazhimit, kërcënimit, shkatërrimit të emrit dhe reputacionit të një personi, ose që personi të paraqitet si objekt seksual. Kjo bëhet pa pëlqimin e personit në foto ose video. Përmbajtja vizuale e përdorur për abuzim mund gjithashtu të krijohet artificialisht, duke përdorur teknologjinë "deepfake". Abuzimi përmes përmbajtjes vizuale përfshin edhe dërgimin e përmbajtjes pornografike dhe seksuale të një personi pa pëlqimin e tij. Pasojat e kësaj forme dhune, përveç atyre psikologjike, mund të jenë edhe sociale: si humbja e vendit të punës ose zhvendosja në një vend tjetër, ku viktimën nuk e njeh askush. Abuzimi përmes fotove përfshin fotografi të bëra nën-fustan pa pajtimin e femrave (angl. upskirting) dhe fotografime perverse; pornografi pa pëlqim dhe zhvatje në baza seksuale; si dhe media seksuale sintetike, siç janë falsifikim i theksuar (deepfake) dhe pornografi e falsifikuar apo e rreme (deepfake).

b) Fotografi të bëra nën-fustan pa pajtimin e femrave dhe fotografime perverse

Fotografi të bëra nën-fustan pa pajtimin e femrave (angl. upskirting) dhe fotografime perverse (angl. creepshots) përfshijnë filmimin e vajzave, adoleshenteve dhe grave në vende publike pa lejen e tyre. Kjo ndodh më shpesh në vende publike, si dyqane, tualete publike, transport publik, dhoma zhveshjeje, klasa apo rrugë, por edhe në banesat private të vajzave, adoleshenteve dhe grave. Fotografi të bëra nën-fustan pa pajtimin e femrave paraqet shkrepje fotosh apo video-regjistrime fshehurazi nën një fund apo fustan^{xxvi}, ndërsa fotografimet perverse përfshijnë marrjen e fotove dhe videove seksualisht sugjestive të një femre pa e vënë re ajo.^{xxvii} Në vitin 2021, në Japoni u regjistrua një "pandemi" e fotografive të bëra nën-fustan pa pajtimin e femrave, kur në gjashtë muajt e parë të vitit 2021 u vu re një rritje prej 30% e raportimeve në polici krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vajzat, adoleshentet dhe gratë janë fotografuar më së shpeshti në transportin publik dhe, përveç celularëve, abuzuesit kanë përdorur edhe teknologji të sofistikuar të ngjashme me pajisjet e spiunazhit - kamera në stilolapsa, syze, në doreza ombrellash dhe këpucë. Që nga viti 2019, metroja e Tokios ka një tren special për gratë, pikërisht për shkak të llojeve të ndryshme të dhunës seksuale me të cilat përballen gratë në transportin publik, duke përfshirë edhe këtë formë digjitale të saj.^{xxviii}

b) Pornografia pa pëlqim dhe zhvatja në baza seksuale

Pornografia pa pëlqim (angl. non-consensual pornography), që shpesh quhet dhe pornografi hakmarrëse (angl. revenge porn), është çdo regjistrim i paautorizuar (me foto-aparat ose kamerë) dhe/ose shpërndarje, si dhe kërcënime për të ndarë, i imazheve në të cilat një person është i zhveshur ose në një situatë me konotacion seksual, ku të gjitha lidhen me synimin për të poshtëruar, turpëruar ose shantazhuar një person.^{xxix} Kur qëllimi është zhvatja, mund të flasim edhe për zhvatjen në baza seksuale

(angl. sextortion), që synon t'i zhasë para një personi ose ta detyrojë atë të bëjë diçka që nuk dëshiron, si për shembull një akt seksual, nën kërcënimin se fotot e tyre nudo ose videot me konotacion seksual do të publikohen. Zhvatja në baza seksuale është një vepër penale në disa shtete, si p.sh. në Mbretërinë e Bashkuar. Me përparimet në teknologjinë dhe softuerin e redaktimit të videove dhe fotografive, pornografia pa pëlqim përfshin në mënyrë progresive edhe pornografinë e rreme (pornografia deepfake), ku këto dy forma mund të përdoren edhe për zhvatje seksuale.

Në fillim të vitit 2021, në Ballkan u zbuluan grupet Telegram Javna soba, Ex Yu Balkanska soba dhe Nišlijke, të cilat përdorëshin për shkëmbimin e pornografisë pa pëlqim. Këto grupe numëronin dhjetëra mijëra anëtarë dhe, përveç shkëmbimit të fotove dhe videove të vajzave, u shkëmbyen edhe të dhënat e tyre personale (ato ishin të doks-uara), si emrat dhe mbiemrat e tyre, numrat e telefonit dhe posta elektronike, adresat apo vegëzat drejt rrjeteve sociale.^{xxx}

b) Media seksuale sintetike, falsifikimi i theksuar (deepfake) dhe pornografi e falsifikuar apo e rreme (deepfake)

Mediat seksuale sintetike (angl. synthetic sexual media) shërbejnë për të manipuluar përmbajtjen e fotografive dhe videove me qëllim të krijimit të përshtypjes se persona të caktuar kanë marrë pjesë në aktivitete seksuale në të cilat, në realitet, nuk kanë marrë pjesë. Arsyet e përdorimit të mediave seksuale sintetike mund të jenë të ndryshme - nga argëtimi, te fitimi i parave, e deri te shantazhimi dhe ngacmimi i grave dhe shkatërrimi i imazhit dhe reputacionit të tyre. Mediat seksuale sintetike paraqesin një term ombrellë, ku dipfejk-ët (falsifikimi i theksuar) janë forma e tyre më e zakonshme.^{xxxi} Dipfejk-ët (falsifikimi i theksuar, angl. deepfakes) janë përmbajtje digjitale fotografike, video dhe audio që më pas ndryshohen ose manipulohen me ndihmën e programeve të specializuara. Qëllimi i një dipfejk-u është të krijojë përshtypjen se dikush tha ose bëri diçka që në realitet

nuk e ka bërë. Dipfejk-u mund të përdoret për qëllime politike, por më shpesh përdoret në formën e pornografisë së rreme. Pornografi e falsifikuar apo e rreme (deepfake) (angl. deepfake pornography) krijohet pa pëlqimin e personit, imazhi i të cilit përdoret në materialin pornografik, dhe është një formë pornografie pa pëlqim.

Pothuajse në të gjitha rastet e pornografisë së rreme (dipfejk), në shënjestër janë femrat, përfshirë personazhe publike, si aktorja Kristen Bell, por edhe femra dhe vajza të panjohura, duke qenë se kjo teknologji është gjithnjë e më e disponueshme financiarisht.^{xxxii} Kjo është arsyeja pse pornografia e rrejshme është pjesë e kodit penal në disa vende, si Kroacia (Keqpërdorimi i përmbajtjes seksualisht eksplicite, neni 144a).

b) Seksting (dërgim i mesazheve me tekste apo materiale pornografike) dhe seksting abuziv

Seksting (dërgim i mesazheve me tekste apo materiale pornografike, angl. sexting) është shkëmbimi elektronik i fotove nudo ose fotove me konotacion seksual, si dhe videove të aktit seksual, dhe përmbajtjeve tekstuale seksuale me pëlqimin e të gjitha palëve. Edhe pse seksting-u shpesh portretizohet si i rrezikshëm, në thelb nuk është kështu, për sa kohë që ka miratim nga të përfshirët, dhe respektohet privatësia e të gjithë të përfshirëve. Nga kjo formë dallohet seksting-u abuziv (angl. abusive sexting), në të cilën mungon pëlqimi i personit të cilit i dërgohet përmbajtja. Nëse njerëzit nuk sillen me përgjegjësi ndaj përmbajtjes së shkëmbyer përmes seksting-ut, dhe nuk respektojnë privatësinë e personit që është pjesë e përmbajtjes, dhe atë përmbajtje ia përcjellin palëve të treta, bëhet fjalë për pornografi pa pëlqim.

Edhe pse djemtë dhe vajzat adoleshente bëjnë seksting në masë të njëjtë, gjasat që djemtë të përcjellin fotot që u dërgohen atyre, palëve të treta, janë dy deri tri herë më të lartë.^{xxxiii} Gjithashtu, hulumtimet tregojnë se përvoja e seksting-ut abuziv është më e zakonshme tek adoleshentët dhe adoleshentet më të rinj, dhe tek para-adoleshentët dhe para-adoleshentet^{xxxiv}, si dhe tek

personat seksualiteti i të cilëve është i ndryshëm nga heteroseksuali.^{xxxv}

b) Kiber-ekzibicionizëm, pornografi e padëshiruar dhe foto dikpik/të padëshiruara të penisit

Kiber-ekzibicionizëm (angl. cyberflashing) paraqet formën e abuzimit përmes fotografive, kur personave të panjohur u dërgohen foto dhe video seksualisht eksplicite, e pa pëlqimin e tyre. Pornografia e padëshiruar (engl. unsolicited pornography) është formë e kiber-ekzibicionizmit në të cilën një person i dërgon personit tjetër, fotografi të padëshiruara të organeve të tij gjentiale ose materiale seksualisht eksplicite, pa pëlqimin e tij.^{xxxvi} Fotografi të padëshiruara të penisit, që shpeshherë quhen dhe dikpik foto (angl. dick pics), përfaqësojnë formën më të zakonshme të pornografisë së padëshiruar. Këto janë foto të penisit, zakonisht në ereksion, të cilat dërgohen përmes internetit. Ekzibicionizmi kibernetik, përveç dikpik-ëve, përfshin edhe forma të tjera të pornografisë së padëshiruar dhe pornografisë pa pëlqim, si dhe foto, video dhe animacione GIF me skena aktesh seksuale, por dhe përdhunimesh.^{xxxvii}

Ekzibicionizmi kibernetik, fotot dikpik dhe pornografia e padëshiruar janë një problem i madh, në masën që Mbretëria e Bashkuar është aktualisht në procesin e miratimit të legjislacionit për të futur këtë sjellje në kodin penal.^{xxxviii} Futja në kod penal u propozua pasi një studim i vitit 2019 zbuloi se 76% e vajzave adoleshente të moshës dymbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç kishin pranuar foto të padëshiruara të penisit.^{xxxix}

b) Regjistrimi dhe/ose transmetimi i sulmeve seksuale dhe përdhunimeve

Dhuna seksuale në mjedisin digjital mund të përfaqëson gjithashtu vazhdimin e dhunës seksuale në botën reale (offline) - shembull është praktika e regjistrimit dhe/ose transmetimit të sulmeve seksuale dhe përdhunimeve (engl. documenting or broadcasting sexual assault/rape videos) në rrjetet sociale, nëpërmjet mesazheve apo faqeve të internetit, që

paraqet një akt shtesë të dhunës seksuale ndaj viktimës/të mbijetuarit. Këto video ndonjëherë përdoren për të poshtëruar ose shantazhuar të mbijetuarit e dhunës seksuale, dhe gjithashtu shiten si pornografi pa pëlqim.

Fushata #NotYourPorn u nis me qëllim të ndërgjegjësimit për mungesën e mekanizmave rregullores në faqet e njohura pornografike, që do të hiqnin ose parandalonin postimin e videove të sulmeve seksuale dhe përdhunimeve, dhe pornografisë pa pëlqim; si dhe materialeve të regjistruara vullnetarisht, e që janë vjedhur nga punëtorët/punëtoret e seksit, dhe janë publikuar pa pëlqimin e tyre.

b) Parapërgatitje (grooming) në internet

Parapërgatitje (grooming) në internet (angl. grooming online) përfaqëson një formë sjelljeje grabitqare, qëllimi i së cilës është vendosja e kontaktit me fëmijë dhe të rinj përmes rrjeteve sociale ose platformave të tjera digjitale, dhe me qëllim të dhunës seksuale. Grumingu (parapërgatitja -grooming) funksionon ashtu që një grumer (angl. groomer, personi që bën parapërgatitjen - grooming) krijon një lidhje të rreme emocionale me objektivin e tij dhe e mashtron atë me qëllim që të kryen abuzimin seksual, shfrytëzimin seksual (për shembull, shfrytëzimin seksual përmes prostitucionit të detyruar) ose trafikimin e fëmijëve. Gjatë parapërgatitjes në hapësirën online, grabitqarët shpesh paraqiten si fëmijë apo të rinj dhe ndonjëherë, kur krijojnë një marrëdhënie, kërkojnë edhe një takim të drejtpërdrejtë, gjë që hap mundësinë për shfrytëzim seksual dhe dhunë seksuale e fizike në hapësirën reale (offline).

Gjatë katër viteve të fundit, në Mbretërinë e Bashkuar, ka pasur një rritje prej 84% në parapërgatitjen në internet. Fëmijët dhe të rinjtë më së shpeshti janë grumuar në rrjetet sociale dhe faqet e lojërave elektronike, dhe grumer-ët kanë kërkuar nga ta që të ju dërgojnë materiale eksplicite seksuale.^{xl}

b) Përvoja të padëshiruara seksuale të drejtpërdrejta, të mundësuar nga teknologjia

Përvojat e padëshiruara seksuale të drejtpërdrejta, të mundësuar nga teknologjia (angl. technology-facilitated unwanted sexual experiences) ndodhin kur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit përdoren për të mundësuar ngacmimin seksual ose dhunën seksuale gjatë takimeve në botën reale (offline). Teknologjitë e përdorura për këtë formë dhune janë më së shpeshti aplikacionet, faqet dhe platformat për takime me partnerë (takime online), përmes të cilave organizohet një takim i drejtpërdrejtë, në të cilin edhe ndodh sulmi seksual.^{xii}

Hulumtimi nga Mbretëria e Bashkuar tregon se numri i njerëzve që raportojnë përdhunim gjatë takimit të parë me dikë që takuan në internet, është rritur gjashtëfish brenda pesë viteve, ku në 85% të rasteve janë gratë ato që kanë raportuar ngjarjet, mes viteve 2003-2015. Më të rrezikuara ishin gratë e reja, të moshës njëzet deri në njëzet e katër vjeç, të cilat kishin dy herë më shumë gjasa të përjetonin një përvojë seksuale të padëshiruar të ndërmjetësuar nga teknologjia, në krahasim me gratë e moshuara.^{xiii}

b) Trafikimi dhe rekrutimi i qenieve njerëzore i ndihmuar nga teknologjia

Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit përdoren edhe në trafikimin e grave dhe vajzave, dhe këtu bëhet fjalë për trafikimin e qenieve njerëzore të ndihmuar nga teknologjia (angl. electronically facilitated trafficking). Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit mund të përdoren edhe për rekrutim (angl. recruitment). Trafikantët e qenieve njerëzore shumë shpesh përdorin internetin për rekrutim duke postuar reklama false për punësim ose studime, më së shpeshti jashtë vendit, ose duke përdorur profile të rreme në aplikacione dhe sajte takimesh, ose në faqet e agjencive të "martesave".^{xiiii} Trafikantët e qenieve njerëzore keqpërdorin teknologjinë edhe në faza të tjera të shfrytëzimit seksual, si dhe kur dërgojnë kërcënime për qëllime detyrimi dhe kontrolli ndaj grave dhe vajzave të

trafikuar, kur bëhet fjalë për zvatje mbi baza seksuale. Platformat e rrjeteve sociale ose aplikacionet dhe faqet e takimeve përdoren më së shpeshti për trafikim njerëzor të ndihmuar nga teknologjia.^{xliv xlv}

Hulumtimi i organizatës Atina, një shoqatë qytetare për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe të gjitha formave të dhunës ndaj grave, tregoi se një numër i madh grash dhe vajzash të trafikuar janë rekrutuar përmes mediave digjitale, ndërsa 30% e tyre janë rekrutuar që mbi to të kryhen edhe forma tjera të dhunës, si përdhunim, grabitje ose dhunë fizike. Më shumë se gjysma e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore kanë hasur edhe në publikimin e reklamave në internet për të "reklamuar" shfrytëzimin e tyre seksual, dhe gjysma kanë qenë edhe viktimat të zvatjes mbi baza seksuale, kur trafikantët i shantazhonin me materiale video.^{xlvi}

Kërcënimi i privatësisë dhe sigurisë përmes teknologjisë

Kërcënimi i privatësisë dhe sigurisë përmes teknologjisë përfshin një seri të tërë veprimesh që synojnë ta bëjnë një person të ndihet i pasigurt, i kërcënuar dhe i padëshiruar, jo vetëm në mjedisin digjital, por edhe në botën reale (offline). Pikërisht kjo përbën një nga karakteristikat më të rëndësishme të këtij grupi sjelljesh - pamundësia për të bërë një dallim të qartë midis mjediseve online dhe reale (offline). Publikimi në internet i informacionit personal për një person pa pëlqimin e tij, doks-imi, dednejm-imi (nxjerrja në shesh i emrave/pseudonimeve të përdorura nga personat me variante gjinore) apo autimi (nxjerrja në shesh i orientimit seksual të personave me variante gjinore) pa pëlqim të tyre, mund të rezultojnë në rrezikimin e sigurisë së atij personi në botën reale (offline); prezantimi i rrejshëm dhe ketfish-imi

(prezantim i rrejshëm me qëllim të mashtrimit) synojnë jo vetëm përfitime financiare, por edhe dhunë seksuale potenciale nëse ndodh një takim i drejtpërdrejtë, dhe teknologjia mund të përdoret edhe për të kufizuar dhe kontrolluar një person të caktuar, më së shpeshti një partneri/partnereje intime, si dhe për abuzim financiar. Kur bëhet fjalë për ndjekjen kibernetike dhe përcjelljen obsesive në internet, ato shpesh ndërlidhen ose i paraprijnë ndjekjes në botën reale (offline), kurse kërcënimet në internet në shumicën e rasteve kanë të bëjnë me jetën e personit jashtë internetit, e që kërcënohet. Kur abuzimi "kalon" nga bota e internetit në atë reale, mund të flasim për sulme "në jetën reale". Gjithashtu, kjo lloj dhune përfshin edhe bombardimin në Google dhe Zoom, si dhe sulmet e refuzimit të qasjes, dhe të refuzimit të shërbimeve.

b) Doks-imi, dednejm-imi dhe autimi pa pëlqim

Doks-imi (angl. doxxing ose doxing) është forma e ngacmimit digjital me bazë gjinore në të cilën një person, dokser-i, mbledh të dhëna mbi personin tjetër, i analizon dhe i publikon ato, të gjitha me qëllimin për ta portretizuar atë person në mënyrë negative dhe për të dëmtuar reputacionin dhe/ose sigurinë e tij/saj.^{xlvii} Në rastin e doksimit, më së shpeshti publikohen të dhënat personale - adresa e vendbanimit ose adresa e postës elektronike, numri i telefonit, kontaktet e punëdhënësve ose anëtarëve të familjes, d.m.th. fotot e fëmijëve ose shkollës që ata vijnë, të gjitha me qëllim të shfaqjes/zbulimit të saktë të vendndodhjes së tij dhe ushtrimit të dhunës fizike.^{xlviii} Forma të veçanta të doksimit paraqesin aut-imi pa pëlqim dhe dednejmim-i, objektivi i të cilave janë anëtarët e komunitetit LGBTQIA+ dhe TIRV. Me rastin e autimit pa pëlqim (engl. non-consensual outing) zbulohet orientimi seksual i një personi LGBTQIA+; dhe me rastin e dednejmimit (engl. deadnaming) zbulohet emri i dhënë në lindje të një trans-personi, për të pakësuar, anuluar ose zhvlerësuar identitetin e atij personi trans. Edhe në rastet e autimit pa pëlqim, dhe në rastet e dednejmimit, doks-imi kryhet me qëllim që atij

personi të i shkaktohet dëm, dhe që personi të jetë i ekspozuar ndaj dhunës dhe diskriminimit, si në botën online, ashtu edhe jashtë saj.^{xlix}

Doks-imi shpeshherë përcjell format e tjera të dhunës me bazë gjinore, ku në veçanti janë të ekspozuara gratë që janë të dukshme në publik, si gazetaret. Gazetarja dhe themeluesja e grupit joformal Gazetarët kundër dhunës, Jovana Gligorijević, ishte shpesh shënjestër e kërcënimeve, gjuhës së urrejtjes gjinore dhe seksiste, si dhe talljes me bazë gjinore, dhe në vitin 2019, në një koment në një video në YouTube, u publikuan numri i saj personal dhe adresa e banimit.^l

b) Prezantimi i rrejshëm dhe ketfish-imi

Prezantimi i rrejshëm (angl. impersonation) është procesi i vjedhjes së identitetit ekzistues të dikujt me qëllim të kërcënimit apo frikësimit, si dhe për të diskredituar ose dëmtuar reputacionin e atij personi.^{li} Një formë e veçantë e paraqitjes së rreme është ketfish-imi (angl. catfishing), gjatë së cilës ndodh përfaqësimi i rremë me qëllim mashtrimi. Ketfish-imi zakonisht ndodh kur viktima bie në dashuri me autorin e krimit, dhe kur viktima zhvillon ndjenja intime dhe beson se janë në lidhje, keqbërësi i kërkon viktimës para ose dhurata për të përfituar financiarisht. Keqbërësi mund të kërkojë edhe informata specifike dhe/ose foto intime, për të shantazhuar më tej viktimën. Si tek prezantimi i rrejshëm, ashtu edhe tek ketfish-imi, gjatë krijimit të identitetit të rremë, keqbërësit shpesh përdorin foto të njerëzve të tjerë, dhe shpikin biografi të detajuara dhe përvoja jetësore false, si dhe punë dhe miq false.^{lii}

Prezantimi i rrejshëm dhe ketfish-imi më së shpeshti zhvillohen në faqet dhe aplikacionet për takime të partnereve, dhe shumica e këtyre faqeve dhe aplikacioneve përipiqen të zhvillojnë mekanizma verifikimi të identitetit për të parandaluar këtë lloj mashtrimi. Në këto raste, qëllimi i ketfishimit nuk është domosdoshmërisht përfitimi financiar, qoftë nëpërmjet dhuratave apo zhatjeve, por edhe dhuna seksuale kur ndodh takimi i drejtpërdrejtë, dhe këtu bëhet fjalë për përvoja të padëshiruara seksuale të

drejtpërdrejta dhe të mundësuar nga teknologjia. Një nga autorët më të famshëm të prezantimit të rrejshëm dhe ketfishim-it është Simon Leviev, i cili ishte subjekt i filmit dokumentar Tinder Swindler. Leviev i mashtroi viktimat e tij për miliona dollarë, dhe është ende në arrati.^{lv}

b) Kufizimi apo kontrollimi nëpërmjet teknologjisë

Abuzuesit mund të përdorin teknologjinë për të abuzuar ose kontrolluar, duke gjurmuar, monitoruar ose kufizuar lëvizjen, komunikimin dhe aktivitetet e atij personi. Këto sjellje ndryshojnë nga detyrimi i një personi, zakonisht një partner/partnere intime, për të dorëzuar fjalëkalimet me qëllim të fitimit të qasjes në llogaritë e tyre në internet, deri në kufizimin ose ndalimin e plotë të përdorimit të pajisjeve teknologjike. Në marrëdhëniet partnere ku ka abuzim, kufizimi ose kontrollimi nëpërmjet teknologjisë (angl. limiting or controlling use of technology) mund t'i paraprijë formave të tjera të abuzimit.^{lv}

Problemi me këtë formë të dhunës me bazë gjinore është se ajo shpesh romantizohet, ku dhënia e fjalëkalimeve personale dhe qasjes në llogaritë në internet, ose instalimi i aplikacioneve gjurmuese prezantohet si një formë kujdesi dhe dëshmie dashurie mes partnerëve. Duke qenë se teknologjia sot është një nga mënyrat se si ne vendosim kontakt me botën e jashtme, kufizimi ose kontrollimi i përdorimit të saj nga një partner është përpjekje për të izoluar, kontrolluar dhe mohuar burimet për të dalë nga ajo marrëdhënie abuzive, e cila është një teknikë e zakonshme e përdorur nga abuzuesit.^{lvi}

b) Abuzimi elektronik financiar

Abuzimi elektronik financiar (angl. electronically enabled financial abuse) është shtrirja apo zhvendosja e dhunës ekonomike në hapësirën digjitale. Ai përfshin mënyra të ndryshme të përdorimit të internetit dhe formave të tjera të teknologjive të informacionit dhe komunikimit për të ushtruar presion financiar mbi një person. Abuzimi financiar elektronik më së shpeshti

përjetohet nga gratë, dhe abuzuesit janë partnerët e tyre intim.

Abuzimi financiar elektronik përfshin mohimin e qasjes në llogaritë bankare përmes internetit, dhe falsifikimin e informatave për të krijuar statusin negativ të kredisë ose për të vjedhur identitetin.^{lvii} Në këtë mënyrë, abuzuesit kanë kontroll të plotë mbi viktimat e tyre, sepse ju mohojnë qasjen në para, si dhe mundësinë për të marrë kredi që të marrin paratë që u nevojiten për të lënë abuzuesit e tyre.^{lviii}

b) Ndjekje kibernetike dhe përcjellje obsesive në internet

Ndjekje kibernetike (angl. cyberstalking) është formë abuzimi në të cilën autori përdor teknologjinë për të ndjekur një person dhe sjelljen e tij në internet. Ajo nuk duhet të përfshijë kërcënime të drejtpërdrejta, por përfshin të gjitha ato aktivitete të cilat tek objektivi i sulmit krijojnë ndjenjë e frikës, shqetësimit, ankthit dhe pafuqisë. Ndjekësi kibernetik do t'i dërgojë mesazhe, do t'i telefonojë ose do t'i dërgojë mesazhe zanore objektivit të tij, me qëllim që ta mbajë atë në gjendje aktive të ankthit dhe frikës së vazhdueshme për sigurinë e tij/saj jashtë linje/interneti.^{lix} Përndjekja obsesive në internet (angl. cyber-obsessional pursuit) karakterizohet nga përdorimi i teknologjisë për të përcjellë një person, dhe ndryshon nga përcjellja kibernetike në atë që nga viktima kërkohet një formë e marrëdhënies intime. Përndjekja obsesive në internet karakterizohet nga kërkesa për intimitet nëpërmjet shkeljeve të privatësisë fizike dhe në internet, dhe përfshin sjellje të tilla si ndjekja në internet dhe jashtë linje, dërgimi i dhuratave të padëshiruara, kërkesa për përcjellje/miqësim në rrjetet sociale, si dhe mesazhe të tilla si postë elektronike (e-mail), mesazhe me tekst, ose mesazhe përmes aplikacioneve të ndryshme.^{lx}

Shpesh mund të dëgjojmë se përndjekja në internet nuk është një gjë e tmerrshme, sepse personi mund të mbyllë llogaritë e tij në internet dhe të "fikë kompjuterin". Kjo, për fat të keq, nuk është e vërtetë – përndjekja kibernetike prek viktimën në të njëjtën mënyrë si përndjekja në

jetën reale, dhe në një numër të caktuar rastesh i paraprin ose është pjesë e ndjekjes së personit në jetën reale (offline).^{lxii} Për këtë arsye, në disa vende, si në Serbi, përndjekja kibernetike është pjesë e kodit penal (në kuadër të veprës penale të përndjekjes, neni 138a i Kodit Penal).

b Sulme "në jetën reale"

Për sulmet "në jetën reale" (angl. in-real-life (IRL) attacks) flasim kur abuzimi në internet kalon në një kontekst jo-digjital, ose është pjesë integrale e ndjekjes ekzistuese ose abuzimit në marrëdhënie mes partnerëve.^{lxiii}

Ndaj sulmeve "në jetën reale" janë veçanërisht të ekspozuara gratë që janë të dukshme në publik, si gazetaret. Gazetaret Daphne Karuna Galizia dhe Gauri Lankesh u vranë në vitin 2017 pasi iu nënshtruan ngacmimeve të rrjetëzuara në internet në formën e kërcënimeve me përdhunim dhe me vdekje.^{lxiii}

b Kërcënimi online

Kërcënimi online është një "deklaratë e qëllimit për të shkaktuar dhimbje, lëndim, dëmtim ose veprim tjetër armiqësor" ndaj personit të cilit i drejtohet. Përveç kërcënimeve me dhunë në mjedisin online; kërcënimet e mohimit të qasjes, kërcënimet për pornografi të rreme (deepfake) ose doks-imi (doxing), kërcënimet janë gjithnjë e më shumë të lidhura me dhunën në botën reale (offline) - këto përfshijnë kërcënime me vdekje, si dhe kërcënime të dhunës fizike dhe/ose dhunës seksuale.^{lxiv}

Gratë që janë të zëshme në hapësirën digjitale kur bëhet fjalë për të drejtat e grave dhe të njeriut janë shpesh objektiv i kërcënimeve. Sipas të dhënave të Shoqatës së Pavarur të Gazetarëve të Serbisë (NUNS), në Serbi, tre të katërtat e kërcënimeve ndaj gazetarëve femra janë përpjekje për të rrezikuar reputacionin e tyre, dhe më shumë se gjysma janë forma të ngacmimeve seksuale dhe kërcënime ndaj sigurisë dhe jetës së tyre.^{lxv}

b Bombardimi në Google dhe Zoom

Bombardimi në Google (angl. Google bombing) përfshin rregullimin e synuar të një algoritmi për të pozicionuar faqet në internet që përmbajnë informacione keqdashëse dhe të pasakta për një person ose fenomen, në mënyrë që ata/ato të shihen të parët ose ndër të parët kur kërkohet një term/koncept ose person i caktuar.^{lxvi}

Nga ana tjetër, bombardimi në Zoom (angl. Zoom bombing) i referohet një "ndërrhyrjeje" të pafutur në bisedën e dikujt tjetër në këtë platformë, me qëllim përhapjen e përmbajtjeve raciste, seksiste, pornografike, homofobike ose antisemitike, me qëllim që të shqetësohen dhe tronditen shikuesit e pranishëm.

Bombardimi në Zoom paraqet një formë të ngacmimit të rrjetëzuar.^{lxvii}

Një shembull i bombardimeve në Google drejtuar kundër grave është ngjarja e vitit 2011, kur aktivistët - kundërshtarë të së drejtës për të ndërprerë shtatzëninë, arritën të rregullojnë algoritmin e Google në mënyrë që faqja e Wikipedia mbi abortin të dalë si rezultati i parë kur kërkohet termi vrasje (angl. murder).^{lxviii}

b) Sulmi përmes mohimit të qasjes, dhe sulmi përmes mohimit të shërbimeve

Sulmi përmes mohimit të qasjes (angl. denial of access) është përdorimi i disa mundësive të teknologjisë ose platformave për të dëmtuar një person, duke i mohuar qasjen në profilin e tij personal në rrjetet sociale ose në postë elektronike. Ekzistojnë dy forma themelore të mohimit të qasjes. E para konsiston nga një sulm të koordinuar nga abuzuesit të cilët raportojnë në mënyrë të rreme dhe bashkërisht llogarinë e një personi, kolektivi ose institucioni për shkak të abuzimit të supozuar ose ndonjë shkeljeje tjetër të rregulave, me qëllim për të bllokuar ose mbyllur atë llogari. Në këtë mënyrë më së shpeshti mohohet qasja në rrjetet sociale. Forma tjetër e kufizimit të qasjes i referohet dërgimit masiv të një numri të madh të porosive elektronike (email-ave) ose vërshimit me mesazhe SMS, qëllimi i të cilave është të parandalojë një person, kolektiv ose institucion që të përdorë një platformë, për shembull postën elektronike, për shkak të bombardimit me një sasi të madhe me përmbajtje të padëshiruar.^{lxix}Përveç sulmit përmes mohimit të qasjes, ekziston dhe sulmi përmes mohimit të shërbimeve – sulmi DoS (angl. Denial of Service). Përderisa qëllimi i sulmit të mohimit të shërbimit është të pamundësohet qasja në platformë ose llogari specifike, qëllimi i një sulmi të mohimit të shërbimit është të pamundësojë qasjen në një kompjuter ose rrjet kompjuterik. Përveç mohimit të qasjes në një kompjuter ose rrjet, sulmet e mohimit të shërbimit mund të komprometojnë informatat e ndjeshme të ruajtura në ato pajisje. Mohimi i shpërndare të shërbimeve - DDoS (angl. Distributed Denial of Service) ndodh kur sulmuesi merr kontrollin mbi kompjuterët të një numri të madh përdoruesish në mënyrë që të sulmon kompjuterin e një përdoruesi tjetër. Në këtë mënyrë, sulmuesi i detyron kompjuterët e "rrëmbyer" të dërgojnë vëllime të mëdha kërkesash në një faqe interneti të caktuar ose të dërgojnë mesazhe të padëshiruara (angl. spam) në adresat e synuara të postës elektronike (e-mail). Sulmet DDoS funksionojnë duke mbingarkuar sistemin me të dhëna të dërguara nga sulmuesi nga kompjuterët të tjerë

Feministët dhe aktivistët në mbarë botën shpesh përballen me sulmin e mohimit të qasjes, sepse bëhet fjalë për një përpjekje për të heshtur dhe hequr zërin e grave. Në Kinë, në vitin 2021, u mbyllën disa kanale feministe në forumet e njohura Douban dhe Weibo. Ato u mbyllën pas një numri të madh raportimesh për "përmbajtje ekstremiste dhe ideologjike", pavarësisht se pronaret e tyre nuk kanë shkelur asnjë nga rregullat e sjelljes në këto rrjete.^{lxx}

Forma të tjera të dhunës në mjedisin digjital

b) Astroturf-imi

Astroturf-imi (angl. astroturfing) është praktika e publikimit dhe shpërndarjes së informatave dhe përmbajtjes (qëllimi i të cilave mund të jetë ngacmimi dhe abuzimi) në internet, me synimin të krijimit të përshtypjes se kjo ka ndodhur në mënyrë të natyrshme, organike, dhe se është një pikëpamje e pranuar përgjithësisht. Qëllimi i astroturf-imit është të krijojë përshtypjen se disa ide dhe përmbajtje kanë mbështetjen e një numri të madh të qytetarëve, edhe pse bëhet fjalë për mashtrim apo falsifikim. Astroturf-imi paraqet një akt të koordinuar me kujdes prapa të cilit qëndrojnë individë, grupe interesi, parti politike apo organizata, dhe që shpesh përfshin llogari të shumta false, të ashtuquajtura bote (engl. bots).

Emri "astroturf-im" buron nga marka e njohur e barit artificial AstroTurf, ku vihet re loja me fjalë - ndryshe nga nismat "grassroots" që përpiqen të imitojnë, astroturf-imi përfaqëson media të krijuara artificialisht dhe fushata reklamuese me qëllim të manipulimit të publikut.

b) Akuzat e rreme për blasfemi

Gratë përballen me kërcënime online në nivel global, por janë në rrezik të veçantë në shtetet fetare konservatore, ku blasfemia është e paligjshme dhe ku vrasjet për nder janë një kërcënim

serioz. Në këtë kuptim, akuzat e rreme për blasfemi (angl. false accusations of blasphemy) mund të bëhen një akt dhune në vetvete.^{lxxi}

Gazetarja dhe mbrojtësja e të drejtave të njeriut Marvi Sirmed nga Pakistani u arrestua në vitin 2020 pasi u akuzua rrejtshëm për blasfemi në rrjetin social Twitter dhe, përveç padisë, Sirmed u përball edhe me kërcënime të shumta.^{lxxii}

b) Tallje (angl. trolling) dhe tallje pas vdekjes bazuar në tronditje dhe pikëllim

Tallja pas vdekjes (angl. RIP trolling) është një formë e dhunës kibernetike që bazohet në publikimin e komenteve të shëmtuara dhe ofenduese për personat e vdekur në faqet përkujtimore në rrjetet sociale, ose në profilet personale të personave të vdekur.^{lxxiii} Tallja në bazë të tronditjes dhe pikëllimit (angl. shock and grief trolling) për cak ka familjarët dhe miqtë e të ndjerit, të cilët shqetësohen përmes krijimit të mimave, faqeve të internetit dhe llogarive false në rrjetet sociale me emrin dhe imazhin e të ndjerit.^{lxxiv}

Dy rastet më të famshme të talljes pas vdekjes dhe talljes në bazë të tronditjes dhe pikëllimit ndodhën në vitin 2010, kur trajnuesen e kafshëve detare Dawn Brancheau e vrau një balenë me të cilën ajo po bënte shfaqje. Pas vdekjes së saj, tallësit vërshuan rrjetet sociale me meme tallëse dhe seksiste, si dhe përmes medimeve sintetike seksiste me imazhin e saj. Pothuajse në të njëjtën kohë, adoleshentja Chelsea King u zhduk, dhe tallësit vendosën të krijonin një seri faqesh përkujtimore (RIP) kushtuar asaj, edhe pse ajo ende nuk ishte gjetur. Pasi u gjet trupi i saj, u krijua një faqe në Facebook me titull "Vë bast se ky kastravec mund të ketë më shumë fansa se Chelsea King" (angl. „I Bet This Pickle Can Get More Fans than Chelsea King”), në të cilën u publikua një foto satelitore e shtëpisë së saj, u kërkua pornografia e saj pa pëlqim, por dhe anëtarët femra të familjes së atyre që u përpoqën të mbronin kujtimin e Chelsea King në komente u kërcënuan me përdhunim.^{lxxv}

b) Svot-imi (angl. swatting)

Svot-imi (angl. swatting, pasi që 'svot' [angl. SWAT – armë dhe taktika të veçanta]), që është emri i shkurtër i njësisë së veçantë të

ndërhyrjes, të policisë) paraqet një raportim të rremë të dhunës, vrasjes, kërcënimit me bombë ose situatave të peng-marrjes tek policia, që rezulton në mbërritjen e një njësie ndërhyrjeje plotësisht të armatosur në një adresë, më së shpeshti një adresë të shtëpisë se dikujt. Svot-imi është i rrallë, por jashtëzakonisht i rrezikshëm, dhe është një shembull i qartë se si ngacmimi në internet ka potencialin t'i shkaktojë dëm serioz një personi, dhe në këtë rast të gjithë familjes së tij, në jetën e tyre të rregullt (jashtë linje - offline).^{lxxvi}

Edhe pse svot-imi shihet shpesh si një shaka, veçanërisht në mesin e gejmer-ave (gamer - lojtarë i lojërave kompjuterike), ai ka pasoja të rënda, duke filluar nga shkatërrimi i pronës, stresi psikologjik, madje edhe lëndime të rënda fizike dhe vdekje. Për fat të mirë, svot-imi në Ballkanin Perëndimor nuk është i përfaqësuar në të njëjtën masë si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku e ka origjinën.

b) Helmimi i hashtag-ut (angl. hashtag poisoning)

Helmimi i hashtag-ut (angl. hashtag poisoning) është krijimi i një hashtag-u fyes, ose, më shpesh, rrëmbimi i një hashtag-u tashmë ekzistues, në mënyrë që kuptimi dhe qëllimi i tij të ndryshohet. Kështu "i helmuar", hashtag-u tanimë përdoret si një thirrje për grumbullim për të kryer një sulm masiv kibernetik (angl. cybermob attack) ndaj një individi, ose përndryshe me synimin për të shkatërruar fushatën fillestare, që shumë shpesh është feministe.^{lxxvii}

Hashtag-ët popullor feminist #TakeBackTheTech dhe #ImagineAFeministInternet, të cilat në vitin 2015 promovuan idenë e një interneti ku gratë do të ishin të sigurta nga dhuna me bazë gjinore, u pushtuan nga një vërshim i koordinuar i gjuhës së urrejtjes gjinore dhe seksiste që synonte të shkatërronte këto fushata.^{lxxviii}

Edhe pse svot-imi shihet shpesh si një shaka, veçanërisht në mesin e gejmer-ave (gamer - lojtarë i lojërave kompjuterike), ai ka pasoja të rënda, duke filluar nga shkatërrimi i pronës, stresi psikologjik, madje edhe lëndime të rënda fizike dhe vdekje. Për fat të mirë, svot-imi në Ballkanin Perëndimor nuk është i përfaqësuar në të njëjtën masë si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku e ka origjinën.

// Koncepte (terma) ^b nga fusha e teknologjisë

A

Algoritëm

Algoritëm është një grup udhëzimesh që i tregojnë kompjuterit se si të zgjidhë një problem, të kryen një funksion ose të kthen një grup të dhënash në informata të dobishme. Algoritmet përdoren në të gjitha fushat e teknologjisë së informacionit. Për shembull, çdo program kompjuterik mund të konsiderohet një algoritëm kompleks.^{lxxxix}

Aplikacioni apo epi (angl. app)

Aplikacionet janë programe softuerike, kryesisht për pajisje celulare si telefonat e mençur dhe tabletët, ku shkarkimi dhe instalimi zakonisht ndodh në të njëjtin hap. Kur instaloni aplikacione, nuk kërkohen veprime shtesë të përdoruesit, dhe aplikacionet mund të hiqen nga pajisja, të çinstalohen, pa ndikuar në funksionimin e saj.^{lxxxix} Është e rëndësishme të theksohet se gjatë instalimit të aplikacioneve në pajisjet celulare, përdoruesi pajtohet me kushtet e përdorimit, të cilat shpesh i referohen ndarjes së të dhënave dhe informatave personale nga pajisja, ndonjëherë duke përfshirë gjeo-lokacionin, por edhe kontaktet nga libri i telefonit.

D

Platforma digjitale

Platformat digjitale janë biznese online që mundësojnë ndërveprimin dhe shkëmbimin e të dhënave, mallrave dhe shërbimeve ndërmjet prodhuesve dhe konsumatorëve, si dhe komunitetit që ndër-vepron me platformën në fjalë. Platformat digjitale mund të jenë platforma të rrjeteve sociale (Facebook, Twitter dhe LinkedIn), platforma njohurish (Yahoo!Answers dhe Google Scholar), platforma për ndarjen e mediave (Spotify, YouTube dhe Netflix) ose platforma të orientuara në shërbime (Airbnb, Amazon, dhe Uber).^{lxxxix}

Teknologjitë digjitale

Teknologjitë digjitale janë mjete, sisteme, pajisje dhe burime elektronike që krijojnë, ruajnë ose përpunojnë të dhëna. Ato përfshijnë infrastrukturën, pajisjet, mediat, shërbimet online dhe platformat që përdorim për qëllime komunikimi, informimi, dokumentimi, rrjetëzimi dhe ndërlidhjeje.^{lxxxii}

Rrjete sociale (shoqërore)

Rrjetet sociale janë një koncept kolektiv për lokacionet e internetit (ueb-sajt) dhe aplikacionet që fokusohen në komunikimin përmes internetit, komentimin në komunitet, ndërveprimin, ndarjen e përmbajtjeve dhe bashkëpunimin. Forumet, mikro-blogjet, rrjetet sociale, faqet dhe/ose platformat për krijimin e koleksioneve të artikujve, imazheve ose postimeve dhe ndarjen e tyre, si dhe përmbajtjet wiki, janë disa nga llojet e ndryshme të rrjeteve sociale që lejojnë transmetimin e shpejtë të përmbajtjes elektronike tek përdoruesit.

Përmbajtja përfshin informata personale, dokumente, përmbajtje video dhe audio, si dhe fotografi. Përdoruesit përdorin rrjetet sociale përmes kompjuterëve, tabletave ose telefonave të mençur, me ndihmën e softuerëve në internet ose aplikacioneve. Platformat e rrjeteve sociale më të përdorura janë Facebook, YouTube, WhatsApp, Facebook Messenger, Instagram dhe TikTok.^{lxxxiii}

Droni

Në kontekstin teknologjik, droni është mjet fluturues pa pilot - një robot fluturues që mund të kontrollohet nga distanca ose të fluturojë në mënyrë të pavarur me ndihmën e planeve të fluturimit të kontrolluara nga softueri i futur në sistemin e tij, i cili funksionon së bashku me ndjesorët (sensor) dhe GPS në fluturake. Dronët quhen gjithashtu "avionë pa pilot" ose "sisteme fluturuese pa pilot" (angl. UAV dhe UAS). Sot, dronët përdoren për një gamë të gjerë rolesh civile, nga kërkimi dhe shpëtimi, te mbikëqyrja, përcjellja e trafikut, të motit, për monitorimin e zjarreve, tek fotografimi personal dhe i biznesit me dron; si dhe video-regjistrimet profesionale, në bujqësi dhe madje edhe për shërbimet e shpërndarjes.^{lxxxiv}

G

GPS dhe përcjellja përmes GPS-së

GPS (shkurt nga Sistemi Global i Pozicionimit - Global Positioning System) është një plejadë prej njëzet e katër satelitësh të pozicionuar mirë që rrotullohen rreth Tokës dhe mundësojnë përcaktimin e vendndodhjes gjeografike të njerëzve me marrës tokësor apo pajisje GPS për gjurmim. GPS mund të përcaktojë gjatësinë, gjerësinë gjeografike, shpejtësinë e tokës dhe drejtimin e lëvizjes së objektivit, dhe saktësia e vendndodhjes është midis dhjetë dhe njëqind metrash për shumicën e pajisjeve. Pajisjet GPS janë të integruara në telefonat e mençur, tabletët dhe pajisjet e navigimit GPS. Teknologjia GPS në telefonat celularë, përveç navigimit, përdoret shpesh për të gjurmuar numrin e hapave përmes aplikacioneve të specializuara për fitnes dhe shëndet. Gjurmimi GPS është mbikëqyrja e vendndodhjes duke përdorur GPS, i cili gjurmon vendndodhjen e një subjekti ose objekti në distancë. Mbrojtësit e privatësisë paralajmërojnë se kjo teknologjia mund gjithashtu të mundësojë reklamuesve, qeverisë, hakerave dhe sulmuesve kibernetikë të gjurmojnë përdoruesit gjatë përdorimit të pajisjeve të tyre celulare.^{lxxxv}

H

Hakerimi (pirateria informatike)

Hakerimi (pirateria informatike) është qasje e paautorizuar në informata dhe programe në pajisjet elektronike dhe rrjetet e tyre – telefona të mençur, kompjuterë, sisteme kompjuterike dhe serverë. Hakerimi mund të jetë keqdashës dhe etik. Hakerimi keqdashës nënkupton qasje të paligjshme ose të paautorizuar në sisteme, që synojnë të sulmojnë, dëmtojnë ose inkrimojnë një person ose organizatë tjetër duke vjedhur ose ndryshuar të dhënat, duke vjedhur informata personale, duke shkelur privatësinë

ose duke infektuar pajisjet me virus.^{lxxxvi} Në këtë rast, hakerimi është një krim dhe hakeri është një kriminel kibernetik. Hakerimi etik i referohet hakerimit që synon zbulimin e të metave të sigurisë brenda sistemeve kompjuterike në mënyrë që të përmirësohet mbrojtja e sistemit.

I

Teknologji e informacionit-komunikimit

Një grup i larmishëm mjetesh dhe burimesh teknologjike të përdorura për të dërguar, ruajtur, krijuar, ndarë ose shkëmbyer të dhëna. Këto mjete dhe burime teknologjike përfshijnë kompjuterët, internetin (faqet e internetit, blogjet dhe postën elektronike), teknologjitë e transmetimit të drejtpërdrejtë (nëpërmjet radios, televizionit dhe internetit), teknologjitë e transmetimit të regjistruar (podkastet, regjistruarit audio dhe video dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave), dhe telefonia (p.sh. pajisje fikse ose celulare, satelitore dhe pajisje për konferenca vizive/video).^{lxxxvii}

M

Mimë (angl. meme)

Mimë ose meme është një format vizual i përbërë nga një imazh dhe një frazë shoqërore. Përveç formatit të imazhit, mima mund të gjendet edhe në formatin e një videoje të shkurtër ose GIF, pra animacion. Si rregull, mimat i referohen disa fenomeneve të kulturës popullore dhe krijohen me idenë për t'u shpërndarë gjerësisht në rrjetet sociale.^{lxxxviii} Edhe pse mima zakonisht ka natyrë humoristike dhe synon t'i bëjë njerëzit të qeshin dhe të bien në humor, ajo gjithashtu mund të jetë tallëse, shqetësuese dhe/ose të përdoret me idenë e abuzimit të një personi.



Platforma online

Platforma online është një shërbim digjital që mundëson ndërveprimin midis dy ose më shumë grupeve të ndryshme, por të ndërvarura të përdoruesve (qoftë kompani ose individë), të cilët ndër-veprojnë përmes shërbimeve nëpërmjet internetit. Termi "platformë online" përdoret për të përshkruar një sërë shërbimesh të disponueshme në internet, duke përfshirë dyqanet online, programet për kërkim, rrjetet sociale, shërbimet me përmbajtje krijuese, dyqanet e aplikacioneve, shërbimet e komunikimit, sistemet e pagesave, shërbimet që përbëjnë të ashtuquajturën ekonomi "kolaborative" apo "gig (ekonomi shërbimesh/punësh anësore)" (punë e pavarur - freelance), dhe shumë të tjera.^{lxix}



Kompani teknologjike^{xc}

Platforma online është një shërbim digjital që mundëson ndërveprimin midis dy ose më shumë grupeve të ndryshme, por të ndërvarura të përdoruesve (qoftë kompani ose individë), të cilët ndër-veprojnë përmes shërbimeve nëpërmjet internetit. Termi "platformë online" përdoret për të përshkruar një sërë shërbimesh të disponueshme në internet, duke përfshirë dyqanet online, programet për kërkim, rrjetet sociale, shërbimet me përmbajtje krijuese, dyqanet e aplikacioneve, shërbimet e komunikimit, sistemet e pagesave, shërbimet që përbëjnë të ashtuquajturën ekonomi "kolaborative" apo "gig (ekonomi shërbimesh/punësh anësore)" (punë e pavarur - freelance), dhe shumë të tjera.



- 1 UN Women. Accelerating Efforts to Tackle Online and Technology Facilitated Violence Against Women and Girls (VAWG). Në dispozicion pranë: https://www.unwomen.org/sites/default/files/2022-10/Accelerating-efforts-to-tackle-online-and-technology-facilitated-violence-against-women-and-girls-en_0.pdf
- 2 Laxton, C. 2014. Virtual World, Real Fear: Women's Aid report into online abuse, harassment and stalking. Bristol, UK: Women's Aid Federation of England.
- 3 European Commission. Proposal for a directive of the European parliament and of the Council on combating violence against women and domestic violence. Strasbourg, 8.3.2022 COM(2022) 105 final 2022/0066 (COD). Në dispozicion pranë: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52022PC0105&from=EN>
- 4 United Nations Human Rights Council. Report by Special Rapporteur Dubravka Šimonović (18 June 2018). Report of the Special Rapporteur on violence against women, its causes and consequences on online violence against women and girls from a human rights perspective. UN Doc A/HRC/38/47.
- 5 EIGE. 2017. Cyber violence against women and girls. Në dispozicion pranë: <https://eige.europa.eu/publications/cyberviolence-against-women-and-girls>
- 6 Cyberbullying Research Centre. What is cyberbullying? Në dispozicion pranë: <https://cyberbullying.org/what-is-cyberbullying>
- 7 Van Der Wilk, A. and M. Natter. 2018. Cyber violence and hate speech online against women. Study for the FEEM Committee.
- 8 Pen America, Online harassment field manual. Në dispozicion pranë: <https://onlineharassmentfieldmanual.pen.org/>
- 9 Radoičić, A. 2020. Iza ekrana: analiza zloupotreba žrtava trgovine ljudima u digitalnom okruženju. Në dispozicion pranë: <http://www.atina.org.rs/sites/default/files/Iza%20ekrana%20Analiza%20zloupotreba%20C5%BERTava%20trgovine%20ljudima%20u%20digitalnom%20okru%20C5%BEenju.pdf>
- 10 VAW Learning Network. 2013. Technology-related Violence Against Women. Në dispozicion pranë: <http://www.vawlearningnetwork.ca/our-work/issue-based-newsletters/issue-4/index.html>
N. Henry and A. Powell, "Technology-facilitated sexual violence: a literature review of empirical research". Trauma, Violence & Abuse, vol. 19, No. 2, (2018), pp. 195–208. <https://doi.org/10.1177/1524838016650189>
Flynn, A., Powell, A., and Hindes, S. 2021. Technology-facilitated abuse: a survey of support services stakeholders (Research report, 02/2021). ANROWS. Në dispozicion pranë: https://20ian81kynqg-38bl3l3eh8bf-wpengine.netdna-ssl.com/wp-content/uploads/2021/07/4AP.4-Flynn_et_al-TFa_Stakeholder_Survey.pdf
- 11 GBV AoR Helpdesk. 2021. Learning Series on Technology-Facilitated Gender-Based Violence. Learning Brief 1: Understanding technology-facilitated GBV.
- 12 Pen America, Online harassment field manual. Në dispozicion pranë: <https://onlineharassmentfieldmanual.pen.org/>
- 13 Pen America, Online harassment field manual. Në dispozicion pranë: <https://onlineharassmentfieldmanual.pen.org/>
- 14 Posetti, J. et al. 2020. Online violence Against Women Journalists: A Global Snapshot of Incidence and Impacts. UNESCO. Në dispozicion pranë: <https://www.icfj.org/our-work/icfj-unesco-global-study-online-violence-against-women-journalists>
- 15 United Nations. 2019. United Nations Strategy and Plan of Action on Hate Speech. Në dispozicion pranë: <https://www.un.org/en/genocideprevention/hate-speech-strategy.shtml>
- 16 Ibid.
- 17 Gordon, S., 2020. Slut-Shaming: The Scarlett Letter Of The 21St Century.
- 18 Mantilla, K., 2013. "Gendertrolling: Misogyny adapts to new media". Feminist studies, 39(2), pp.563-570.
- 19 Women's Media Centre. WMC Speech Project: Online Abuse 101. Në dispozicion pranë: <https://womensmediacenter.com/speech-project/online-abuse-101>
- 20 eSafety Commission Australia. Online abuse targeting women. Në dispozicion pranë: <https://www.esafety.gov.au/women/online-abuse-targeting-women>
- 21 Women's Media Centre. WMC Speech Project: Online Abuse 101. Në dispozicion pranë: <https://womensmediacenter.com/speech-project/online-abuse-101>
- 22 Kumar, R. 2022. DCW chief Swati Maliwal gets rape threats after she seeks 'MeToo' accused Sajid Khan's ouster from Bigg Boss. India TV News. Në dispozicion pranë: <https://www.indiatvnews.com/news/india/dcw-chief-swati-maliwal-gets-rape-threats-after-she-seeks-me-too-accused-sajid-khan-s-ouster-from-bigg-boss-16-filmmaker-2022-10-12-815679>
- 23 Douglas, D. "Doxing: a conceptual analysis", Ethics Information Technology, vol. 18,(2016), pp. 199–210.
Dunn, S. "Technology-facilitated gender-based violence: An overview." Centre for International Governance Innovation: Supporting a Safer Internet Paper 1 (2020).
- 23 Lagan, B. 2021. Australian law will force social media firms to unmask trolls. The Times. Në dispozicion pranë: <https://www.thetimes.co.uk/article/new-australian-law-will-force-social-media-firms-to-unmask-trolls-tqchmf6k9>
- 23 Flynn, A., Powell, A., and Hindes, S. 2021. Technology-facilitated abuse: a survey of support services stakeholders (Research report, 02/2021). ANROWS. Në dispozicion pranë: https://20ian81kynqg38bl3l3eh8bf-wpengine.netdna-ssl.com/wp-content/uploads/2021/07/4AP.4-Flynn_et_al-TFa_Stakeholder_Survey.pdf McGlynn, C. E. Rackley and R. Houghton, "Beyond 'revenge porn': the continuum of image-based sexual abuse", Feminist Legal Studies, vol. 15, (2017), pp. 1–22.
- 24 Flynn, A., Powell, A., and Hindes, S. 2021. Technology-facilitated abuse: a survey of support services stakeholders. (Research report, 02/2021). ANROWS. Në dispozicion pranë: https://20ian81kynqg38bl3l3eh8bf-wpengine.netdna-ssl.com/wp-content/uploads/2021/07/4AP.4-Flynn_et_al-TFa_Stakeholder_Survey.pdf

- 25 Dictionary.com. Creepshot. Në dispozicion pranë: <https://www.dictionary.com/e/slang/creepshot/#:~:text=Creepshot%20typically%20refers%20to%20a,backside%2C%20legs%2C%20or%20cleavage.>
- 26 Ryall, J. 2021. Japan records surge in upskirt photography, perverts 'bored' amid pandemic to blame, experts say. South China Morning Post. Në dispozicion pranë: <https://www.scmp.com/week-asia/lifestyle-culture/article/3150610/coronavirus-boredom-moves-japanese-perverts-upskirt>
- 27 Cvetinčanin Knežević, Hristina. „Digitalno okruženje i rodno zasnovano nasilje – prilog proučavanju.” Antropologija (2020).
- 28 Cvetinčanin Knežević, Hristina. 2021. „'Someone's Daughter': Unpunished Revenge Porn's Terrifying Toll in The Balkans.” Balkan Insight. Në dispozicion pranë: <https://balkaninsight.com/2021/10/18/someones-daughter-unpunished-revenge-porns-terrifying-toll-in-the-balkans/>
- 29 Dunn, S. "Technology-facilitated gender-based violence: An overview." Centre for International Governance Innovation: Supporting a Safer Internet Paper 1 (2020).
- 30 Selbie, T. and C. Williams. 2021. Deepfake pornography could become an 'epidemic', expert warns. BBC. Në dispozicion pranë: <https://www.bbc.com/news/uk-scotland-57254636>
- 31 APC. 2020. How Technology is Being Used to Perpetrate Violence Against Women – And to Fight it. Në dispozicion pranë <https://www.apc.org/en/-pubs/research/how-technology-being-used-perpetrate-violence-agai>
- 32 Rice, E., Gibbs, J., Winetrobe, H., Rhoades, H., Plant, A., Montoya, J., et al. 2014. Sexting and sexual behavior among middle school students. Pediatrics 134, e21–e28.
- 33 Van Oosten, J. M. F., Peter, J., and Vandenbosch, L. 2017. Adolescents' sexual media use and willingness to engage in casual sex: differential relations and underlying processes. Hum. Commun. Res. 43, 127–147.
- 34 Flynn, A., Powell, A., and Hindes, S. 2021. Technology-facilitated abuse: a survey of support services stakeholders (Research report, 02/2021). ANROWS. Në dispozicion pranë: https://20ian81kynqg38bl3l3eh8bf-wpengine.netdna-ssl.com/wp-content/uploads/2021/07/4AP.4-Flynn_et_al-TFa_Stakeholder_Survey.pdf
- 35 Women's Media Centre. WMC Speech Project: Online Abuse 101. Në dispozicion pranë: <https://womensmediacenter.com/speech-project/online-abuse-101>
- 36 Huet, N. 2022. Cyberflashing: People who send unwanted 'dick pics' will face jail under UK's new online safety law. EuroNews. Në dispozicion pranë: <https://www.euronews.com/next/2022/03/14/cyberflashing-people-who-send-unwanted-dick-pics-will-face-jail-under-uk-s-new-online-safe>
- 37 Ringrose, J. 2020. 'Staying Safe Online' survey: what unwanted sexual images are being sent to teenagers on social media?. London's Global University. Në dispozicion pranë: <https://blogs.ucl.ac.uk/ioe/2020/06/19/staying-safe-online-survey-what-unwanted-sexual-images-are-being-sent-to-teenagers-on-social-media/>
- 38 National Society for the Prevention of Cruelty to Children. 2022. Online grooming crimes have risen by more than 80% in four years. Në dispozicion pranë: <https://www.nspcc.org.uk/about-us/news-opinion/2022/online-grooming-crimes-rise/>
- 39 Flynn, A., Powell, A., and Hindes, S. 2021. Technology-facilitated abuse: a survey of support services stakeholders (Research report, 02/2021). ANROWS. Në dispozicion pranë: https://20ian81kynqg38bl3l3eh8bf-wpengine.netdna-ssl.com/wp-content/uploads/2021/07/4AP.4-Flynn_et_al-TFa_Stakeholder_Survey.pdf
- 40 Flynn, A., Powell, A., and Hindes, S. 2021. Technology-facilitated abuse: a survey of support services stakeholders (Research report, 02/2021). ANROWS. Në dispozicion pranë: https://20ian81kynqg38bl3l3eh8bf-wpengine.netdna-ssl.com/wp-content/uploads/2021/07/4AP.4-Flynn_et_al-TFa_Stakeholder_Survey.pdf
- 41 APC. 2020. How Technology is Being Used to Perpetrate Violence Against Women – And to Fight it. Në dispozicion pranë <https://www.apc.org/en/-pubs/research/how-technology-being-used-perpetrate-violence-agai>
- 42 Report of the Special Rapporteur on Violence against Women, Its Causes and Consequences on online violence against women and girls from a human rights perspective, 2018.
- 43 Brittany, A. "On-Ramps, Intersections, and Exit Routes: A Roadmap for Systems and Industries to Prevent and Disrupt Human Trafficking", Polaris, 2018.
- 44 Radoičić, A. 2020. Iza ekrana: analiza zloupotreba žrtava trgovine ljudima u digitalnom okruženju. Në dispozicion pranë: <http://www.atina.org.rs/sites/default/files/Iza%20ekrana%20Analiza%20zloupotreba%20%C5%BErtava%20trgovine%20ljudima%20u%20digitalnom%20okru%C5%BEenju.pdf>
- 45 Radoičić, A. 2020. Iza ekrana: analiza zloupotreba žrtava trgovine ljudima u digitalnom okruženju. Në dispozicion pranë: <http://www.atina.org.rs/sites/default/files/Iza%20ekrana%20Analiza%20zloupotreba%20%C5%BErtava%20trgovine%20ljudima%20u%20digitalnom%20okru%C5%BEenju.pdf>
- 46 Douglas, D., "Doxing: a conceptual analysis", Ethics Information Technology, vol. 18, (2016), pp. 199–210.
- 47 Women's Media Centre. WMC Speech Project: Online Abuse 101. Në dispozicion pranë: <https://womensmediacenter.com/speech-project/online-abuse-101>
- 48 Redakcija. ND. Sapštenje redakcije «Vremena» povodom pretnji Jovani Gligorijević. Vreme. Në dispozicion pranë: <https://www.vreme.com/projekat/sapstenje-redakcije-vremena-povodom-pretnji-jovani-gligorijevic/>
- 49 Van der Wilk, A. 2018. Cyber violence and hate speech online against women. Study for the FEEM Committee.
- 50 eSafety Commission Australia. Catfishing. Në dispozicion pranë: <https://www.esafety.gov.au/young-people/catfishing>
- 51 Radoičić, A. 2020. Iza ekrana: analiza zloupotreba žrtava trgovine ljudima u digitalnom okruženju. Në dispozicion pranë: <http://www.atina.org.rs/sites/default/files/Iza%20ekrana%20Analiza%20zloupotreba%20%C5%BErtava%20trgovine%20ljudima%20u%20digitalnom%20okru%C5%BEenju.pdf>
- 52 Wikipedia. Simon Leviev. Në dispozicion pranë: https://en.wikipedia.org/wiki/Simon_Leviev
- 53 Levy, K and B. Schneier, "Privacy threats in intimate relationships", Journal of Cybersecurity (Oxford), vol. 6, No. 1, (2020), <https://doi.org/10.1093/cybsec/tyaa006>

- 54 Havard, T.E. and M. Lefevre. "Beyond the power and control wheel: How abusive men manipulate mobile phone technologies to facilitate coercive control." *Journal of gender-based violence* 4, no. 2 (2020): 223-239.
- 55 Women's Media Centre. WMC Speech Project: Online Abuse 101. Në dispozicion pranë: <https://womensmediacenter.com/speech-project/online-abuse-101>
- 56 PenzeyMoog, E. and D. C. Slakoff. "As technology evolves, so does domestic violence: Modern-Day tech abuse and possible solutions." In *The Emerald International Handbook of Technology-Facilitated Violence and Abuse*, pp. 643-662. Emerald Publishing Limited, 2021.
- 57 Radoičić, A. 2020. Iza ekrana: analiza zloupotreba žrtava trgovine ljudima u digitalnom okruženju. Në dispozicion pranë: <http://www.atina.org.rs/sites/default/files/iza%20ekrana%20Analiza%20zloupotreba%20C5%BERTava%20trgovine%20ljudima%20u%20digitalnom%20okru%20C5%BEenju.pdf>
- 59 Ibid.
- 60 Henry, N. and A. Powell, "Technology-facilitated sexual violence: a literature review of empirical research". *Trauma, Violence & Abuse*, vol. 19, No. 2, (2018), pp. 195–208. <https://doi.org/10.1177/1524838016650189>
VAW Learning Network. 2013. Technology-related Violence Against Women. Në dispozicion pranë: http://www.vawlearningnetwork.ca/our-work/issue-based_newsletters/issue-4/index.html
- 61 Women's Media Centre. WMC Speech Project: Online Abuse 101. Në dispozicion pranë: <https://womensmediacenter.com/speech-project/online-abuse-101>
- 62 Posetti, J., J. Harrison and S. Waisbord. 2020 Online Attacks on Women Journalists Leading to 'Real World' Violence, New Research Shows. International Center for Journalists. Në dispozicion pranë: <https://www.icfj.org/news/online-attacks-women-journalists-leading-real-world-violence-new-research-shows>
- 63 Pen America, Online harassment field manual. Në dispozicion pranë: <https://onlineharassmentfieldmanual.pen.org/>
- 64 Lončar, S. 2021. Kako internetski nasilnici napadaju novinarkе. Nezavisno udruženje novinara Srbije. Në dispozicion pranë: <https://nuns.rs/kako-internetski-nasilnici-napadaju-novinarke/>
- 65 Women's Media Centre. WMC Speech Project: Online Abuse 101. Në dispozicion pranë: <https://womensmediacenter.com/speech-project/online-abuse-101>
- 66 Dunn, S. "Technology-facilitated gender-based violence: An overview." Centre for International Governance Innovation: Supporting a Safer Internet Paper 1 (2020).
- 67 CBS News. 2011. New "Google Bomb" links murder to abortion. CBS News. Në dispozicion pranë: <https://www.cbsnews.com/news/new-google-bomb-links-murder-to-abortion/>
- 68 Pen America, Online harassment field manual. Në dispozicion pranë: <https://onlineharassmentfieldmanual.pen.org/>
- 70 Yang, W. 2021. China feminists face clampdown, closure of online accounts. Deutsche Welle. Në dispozicion pranë: <https://www.dw.com/en/china-feminism-free-speech/a-57277438>
- 71 Ibid.
- 72 Amnesty International. 2020. Pakistan: Accusations of blasphemy continue to endanger lives. Amnesty International. Në dispozicion pranë: <https://www.amnesty.org/en/latest/news/2020/08/accusations-of-blasphemy-in-pakistan-continue-to-endanger-lives/>
- 73 Phillips, W. "LOLing at tragedy: Facebook trolls, memorial pages and resistance to grief online." *First Monday* (2011).
- 74 Women's Media Centre. WMC Speech Project: Online Abuse 101. Në dispozicion pranë: <https://womensmediacenter.com/speech-project/online-abuse-101>
- 75 Phillips, W. "LOLing at tragedy: Facebook trolls, memorial pages and resistance to grief online." *First Monday* (2011).
- 76 Women's Media Centre. WMC Speech Project: Online Abuse 101. Në dispozicion pranë: <https://womensmediacenter.com/speech-project/online-abuse-101>
- 77 Pen America, Online harassment field manual. Në dispozicion pranë: <https://onlineharassmentfieldmanual.pen.org/>
- 78 Pen America, Online harassment field manual. Në dispozicion pranë: <https://onlineharassmentfieldmanual.pen.org/>
- 79 APC WRP. 2015. Take Action for #TakeBackTheTech and #ImagineAFeministInternet. APC. Në dispozicion pranë: <https://www.apc.org/en/-pubs/take-action-takebackthetech-and-imagineafeministin>
- 80 The Conversation 2020. What is an algorithm? How computers know what to do with data. Në dispozicion pranë: <https://theconversation.com/what-is-an-algorithm-how-computers-know-what-to-do-with-data-146665>
- 81 Techopedia. 2012. App. Në dispozicion pranë: <https://www.techopedia.com/definition/28104/app>
- 82 BMC blogs. 2020. Digital Platforms: A Brief Introduction. Në dispozicion pranë: <https://www.bmc.com/blogs/digital-platforms/#>
- 83 GBV AoR Helpdesk. 2021. Learning Series on Technology-Facilitated Gender-Based Violence. Learning Brief 1: Understanding technology-facilitated GBV.
- 84 GBV AoR Helpdesk. 2021. Learning Series on Technology-Facilitated Gender-Based Violence. Learning Brief 3: Implications of technology-facilitated GBV and actions for humanitarian agencies, donors and online industries.
- 85 Drone (UAV). 2019. IoT Agenda. Në dispozicion pranë: <https://internetofthingsagenda.techtarget.com/definition/drone>
- 86 WhatIs.com. 2014. GPS tracking. Në dispozicion pranë: <https://whatis.techtarget.com/definition/GPS-tracking>
- 87 Pen America, Online harassment field manual. Në dispozicion pranë: <https://onlineharassmentfieldmanual.pen.org/>
VAW Learning Network. 2013. Technology-related Violence Against Women. Në dispozicion pranë: http://www.vawlearningnetwork.ca/our-work/issue-based_newsletters/issue-4/index.html
VAW Learning Network. 2013. Technology-related Violence Against Women. Në dispozicion pranë: http://www.vawlearningnetwork.ca/our-work/issue-based_newsletters/issue-4/index.html

- 88 UNESCO Institute for Statistics. Glossary: Information and communication technologies (ICT). Në dispozicion pranë: <http://uis.unesco.org/en/glossary>
- 89 Internet meme. 2022. Wikipedia. Në dispozicion pranë: https://en.wikipedia.org/wiki/Internet_meme
- 90 OECD. 2019. An Introduction to Online Platforms and Their Role in the Digital Transformation. Në dispozicion pranë: https://www.oecd-ilibrary.org/science-and-technology/an-introduction-to-online-platforms-and-their-role-in-the-digital-transformation_53e5f593-en
- 90 Online Safety Act 2021 (Cth). No. 76, 2021. (Austl.)
- 91 TechTarget. 2021. Spyware. Në dispozicion pranë: <https://searchsecurity.techtarget.com/definition/spyware>.
- 92 IBM. 2020. Artificial Intelligence (AI). Në dispozicion pranë: <https://www.ibm.com/cloud/learn/what-is-artificial-intelligence>

// Trupi yt është i yti
si në internet ashtu edhe në botën reale

b

